



KUR AGON DIELLI I
RIMËKËMBJES SË YMETIT...



PËRSE ERDOGANI FLET
PËR VITIN 2023?



HARMONIA BASHKËSHORTORE
NË AJETIN: "AI VURI MES JUSH
DASHURI DHE MËSHIRË"

Viti XVI - Nr. 7 (185),
Korrik, 2018

Botim i Myftinisë Shkodër

UDHA ISLAME

E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

Kështu na mësuhan Hoxhallarët tanë, *ujet ndriçues të këtij njerëzimi!*

Hoxhallarët tanë, ujet ndriçues të këtij njerëzimi,
përherë na edukuan të merremi me veten dhe të mos e lëshojmë
gjuhën në hak të tjerëve dhe të metave a gabimeve të tyre.





Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Asnjëherë mos u ndalni me seriozitet dhe detaje që zgjojnë urrejtje e përçarje në mesin e muslimanëve, tek deklaratat, komentet a reagimet emocionale prej adoleshenti, të kujtdo që humbet ekuilibrin mendor dhe shpirtëror për shkak të cënimit të interesit të ngushtë, a për shkak të ambicies personale, mbi bazën e së cilës mund të ketë ndërtuar jetën!

Hoxhallarët na kanë mësuar se, në të dy rastet kemi të bëjmë me përpjekje për të triumfuar fanatizmin dritëshkurtër, që në Kur'anin Famëlartë qortohet me të madhe!

Dhe, të vërshosh drejt mbrojtjes së fanatizmit dritëshkurtër plot krenari dhe mburrje, do të thotë se je i paedukatë, i paformuar, tekanjoz i sëmurë, manjak i dëshpëruar, pa bosht edukate shpirtërore e fetare, edhe nëse pretendon ditë e natë se i përket botës së besimit dhe fesë, siç tërhiqte

KËSHTU NA MËSUAN HOXHALLARËT TANË, YJET NDRIÇUES TË KËTIJ NJERËZIMI!

vëmendjen e banorëve të Bagdadit i madhi Sejjidi Abdulkadir Xhejlani.

Fundja, krejt ne të racës njerëzore jemi të mangët, plot gabime e rrëshqitje, që nëse i konstatojmë dhe i pranojmë, duke u përpjekur t'i korrigjojmë, i kemi bërë një shërbim të madh vetes dhe shoqërisë.

Si të thuash, të gjithë pa përjashtim jemi të ftuar të hyjmë në Hiranë e edukimit të nefsit dhe perfeksionimit të rrugëtimeve të saj drejt pastrimit dhe veshjes me virtyte e cilësi të larta, siç mësuam nga ajka e papërlyer e racës tonë!

Tek ne në Islam, ka dy detaje të rëndësishme në këtë rrugëtim; fillimisht *domosdoshmëria e mësuesit edukator, Hoxhës; së dyti, durimi dhe sakrifica në këtë rrugëtim fisnik, deri në frymën e fundit!*

Prandaj, Hoxhallarët tanë, yjet ndriçues të këtij njerëzimi, përherë na edukuan të merremi me veten dhe të mos e lëshojmë gjuhën në hak të tjerëve dhe të metave a gabimeve të tyre.

E, nëse e bëjmë këtë, do dëshmonim ruajtjen e amaneteve të më të mirëve e më fisnikëve! "Ruaie gjuhën tëndel!", thoshte Hz. Muhammedi (a.s)... E kundërta, do ishte një rrëshqitje flagrante, që do dëshmonte se, sado që mund të jemi rritur në moshën biologjike dhe pozitativat e përkohshme të kësaj bote, (të merituar dhe të pamerituar), kemi mbetur ende të vegjël dhe fatkeqësisht,

shumë e shumë mësim nga Hoxhallarët tanë, nuk i kemi kuptuar e përvetësuar s'i duhet.

Gjithsesi, përtej adoleshencës dhe

**Hoxhallarët tanë,
yjet ndriçues të këtij
njerëzimi, përherë na
edukuan të merremi
me veten dhe të mos e
lëshojmë gjuhën në hak
të tjerëve dhe të metave
a gabimeve të tyre.**

nxitimit, emocioneve të çastit dhe formimit të cekët, përherë tek ne në Islam ka shpresë dhe kthim me vetëdije dhe ndërgjegje të qetë drejt udhëzimit të Hoxhallarëve, që trashëgojnë të Dërguarit e All-llahut, në udhëzim, dije dhe urtësi!

Kështu na mësuam Hoxhallarët tanë, yjet ndriçues të këtij njerëzimi!

Shkodër, 25 qershor 2018

KUR AGON DIELLI I RIMËKËMBJES SË YMETIT...

Heronjtë e mëdhenj të historisë sonë mbeten përherë pika referimi në rrugën e rimëkëmbjes.

Një ymet që u ngjiz me thirrjet hyjnore për dije, durim, mëshirë, drejtësi, ndershmëri, paqe, qëndrueshmëri para sfidave, butësi në mes vete, forcë në përballje me armiqtë, edukim, largpamësi, mbrojtje të të shtypurve, bamirësi dhe përkrahje për skamnorët, ekonomi të fortë, zhvillim shkencor, por jo vetëm, nuk mund të qëndrojnë përherë në hutim dhe larg zhvillimit.

Zhvillimet e dekadës së fundit në botën

dhe rikthimit të madhështisë së ymetit të Hz. Muhammed Mustafasë, tashmë ka aguar! Nuk ka kuptim të vazhdojë pafundësisht kjo gjendje e padrejtë!

Secili është i ftuar të punojë me sa ka mundësi dhe forcë për këtë epokë të re, në të cilën nuk lejohet humbja e kohës, përçarja, largimi nga njëri-tjetri, sektarizimi vrastar, xhematizimi fanatik, izolimi dhe mbyllja në guackat e thirrjeve të xhahilijes!

Mos u shqetësoni për fenë e All-llahut dhe Thirrjen e Tij! Ato do vazhdojnë të ndriçojnë njerëzinë dhe të ftojnë Njeriun drejt paqimit me veten, Zotin



islame, pushtimet barbare të tokave dhe shteteve të tyre, keqpërdorimi i fesë nga qarqe të huaja, me qëllim njollosjen e saj; përhapja e urrejtjes kundër Islamit dhe muslimanëve, shfrytëzimi i figurave të caktuara anembanë botës islame për përhapjen e mendimeve dhe lëvizjeve të reja islame, që e mbajnë ymetin në përgjumje dhe pasivitet intelektual, politik dhe ekonomik; pandershmëria e organizmave botërore në trajtimin e çështjeve të ndryshme që lidhen me interesin e muslimanëve në botë, etj., janë mjaftueshëm arsye për mbajtjen e frymës dhe mospranimin e shfrytëzimit të kohës dhe e energjive tona për qëllimet e tyre!

Ymeti po zgjohet! Dielli i rimëkëmbjes

dhe gjithësinë! Amaneti i Tij nuk humbet asnjëherë, për asnjë arsye, për asnjë propagandë, për asnjë forcë në botë, që përpiqet pa ia nda, që ky besim e kjo fë të zbehen, të mjugullohen, të tjetërsohen!

Mos u shqetësoni për fenë e Hz. Muhammedit (a.s.) se, Dritën e Thirrjes së tij s'e shuan asgjë në botë!

Lutuni të na bëjë All-llahu prej burrave që dinë të ruajnë amanetet, që jetojnë për ta dhe që me madhështinë e shpirtit islam dinë të thërrasin gjithësinë drejt tij, me krenari në mesin e njerëzve dhe përluje vetëm para duarve të Krijuesit!

Imam Muhamed B. Sytari

Myfti i Zonës Shkodër
Shkodër, më 24 qershor 2018



PEJGAMBERI (A.S) KA THËNË:

"Arroganca

dhe imitimi i saj

nuk kanë asgjë

të përbashkët me

Islamin!

Njerëzit me

Islamin më të mirë,

janë ata që kanë

mirësjelljen më të

përsosur"

(Transmetuar nga Ahmed, Ebu Ja'la dhe Tabariani)

Në një ditë të bukur Ramazani, 2018/1439 h., prof. dr. Asim El-Karjuti¹, në profilin e tij në Tweet-ër, publikoi një dorëshkrim të hoxhës së hadithit, Nasirudin Albanit². Në një faqe fletoreje, të shkruar me dorën e tij, si këshillë për hoxhën Fuad Abdullah Ed-Derkezlij³, hoxha shqiptar shënon:

“Bismilahirr-Rrahmanirr-Rrahim.

E këshilloj vëllanë, Fuad Abdullah Ed-Derkezlij, që të bëjë kujdes dhe të përpqet për ta kuptuar Islamin drejtë, qoftë në aspektin besimor, juridik dhe moral, nën dritën e Kur'anit dhe të Sunetit të saktë, aq sa ka mundësi.

Le të ndihmohet për këtë qëllim, me librat e dijetarëve të njohur për pastërtinë e besimit dhe metodologjinë e tyre të drejtë, si shembulli i gjashtë imamëve të hadithit⁴ dhe i të tjerëve; i katër fukahave të mëdhenj⁵, Allahu i mëshiroftë që të gjithë; Shejhul-Islami Ibn Tejmije dhe nxënësit të tij të dalluar Ibn Kajim El-Xheuzije; El-Emir Es-San'anit dhe Imam Sheukanit, e i të tjerëve.

Le të pajiset me moralin Islam profetik dhe le të mos ndikohet nga rrymat bashkëkohore perëndimore, prej të cilave është feminiteti dhe imitimi, si rrualtja e mjekrës.

E lus Allahun të na e marrë shpirtin, ne dhe atij (Fuadit), mbi parimet e Kuranit dhe të Sunetit dhe të na bashkojë nën flamurin e Profetit tëTij, sal-lall-llahu alejhi ve sel-le.

12/01/1385

1. . Prof. dr. Asim El-Kurjuti, i lindur më 1954, është profesor i lëndës së Hadithit, në Universitetin Islamik të Rijadit, Imam Muhamed ibn Saud. Është aktivist në fushën e edukimit, nxënës i hoxhë Nasirudin Albanit. Allahu e ndihmoftë!

2. . Nasirudin Albani u lind më 1914 në Shkodër, vdiq më 1999 në Aman, Jordani. I kaloi 70 vite të jetës së tij në shërbim të diturive islame, në përhapjen dhe redaktimin e Sunetit Profetik. Motoja e veprimtarisë së tij ishte: Et-Tasfijeh ve Terbijeh – Pastrim dhe Edukim. Pastrimi i Islamit nga adetët, zakonet, idetë e huaja, hadithet e shpikura që i janë veshur gjatë shekujve dhe edukimin e brezave të rinj mbi bazat e shëndosha fetare.

3. . Fuad Abdullah Ed-Derkezlij, i lindur në Bagdad më 1934 dhe vdiq po aty më 2003. I diplomuar në Sheriatin Islam, në Bagdad. I njohur si ashik i librave dhe i udhëtimeve për t'u takuar me dijetarë. Allahu e mëshiroftë!

4. . Gjashtë imamët e njohur të hadithit janë: Buhariu, Muslimi, Ebu Davudi, Tirmidhiu, Nesaïu dhe Ibn Maxheh, Allahu i mëshiroftë!


5. . Katër dijetarët e medh'hebeve të njohura janë: Ebu Hanife, Maliku, Shafiu, Ahmed ibn Hanbeli, Allahu qoftë i kënaqur me ta!

NDALESË NË NJË DORËSHKRIM

Damask, Biblioteka Dhahirijeh.

Muhamed Nasirudin el-Albani.”

Hoxha shqiptar, Nasirudin Albani, është figurë e admiruar për njohjen e shkëlqyer të fushës së haditheve dhe rigozitetin shkencor. Dua të theksoj se ai, si dijetar, ishte provë e suksesit të aftësive të huajve, joarabëve, dhe vijues i denjë i arritjeve shkencore fetare nga joarabët.



dua të veçoj janë:

- Misioni ynë, si besimtarë, është këshillimi dhe orientimi i drejtë i njëri-tjetrit në parimet kur'anore dhe profetike. Ndjenja fetare është instinkt i natyrshëm i njeriut dhe botëkuptimi i fesë duhet të jetë i plotë, jo i ngushtë, as fasadë, por me të gjitha aspektet e saj, akide, fik'h, moral. Besimi i sjell njeriut qetësinë e mendjes dhe të shpirtit, i

Më vjen shumë keq, kur njerëz jokompetentë, nga shalli i çallmës e deri te çorapet, mëtojnë t'i hedhin poshtë metodën dhe arritjet e hoxhë Nasirudin Albanit. Dua t'u kujtoj këtyre, se në këtë botë vërtet ka vend edhe për dritën e dijes, edhe për tifozerinë e verbër, por e para nuk ka nevojë për të dytën, që të shkëlqejë.

Trashëgimia shkencore e hoxhallarëve shqiptarë, Albani, dy Arnautët dhe Gavoçi (Allahu i mëshiroftë!), është pasuri e paçmuar e kulturës muslimane shqiptare, por jo vetëm, si dhe dëshmi e model se si mund të krijohet një traditë e pasur shkencore islame, në trevat tona.

Teksa analizoja dorëshkrimin e hoxhë Nasirudin Albanit, më tërhoqën vëmendjen mjaft mesazhe të dobishme. Duke dashur që të përfitojnë sa më shumë prej këshillës së hoxhës, mendova ta përshtas dhe ta prezantoj atë për xhematin e besimtarëve. Prej pikave që

ushqen shpresën për diçka më të mirë, e largon njeriun nga hakmarrja, i forcon ndjenjën e drejtësisë. Besimi lufton egoizmin, makutërinë, burimin e të këqijave sociale.

- Pikëreferim për besimtarin janë dijetarët e ymetit, imamët e hadithit dhe të fik'hut. Respektimi i dijetarëve dhe lutja për ta është detyrë për çdo besimtar. Besimtari kundërshton fanatizmin, tifozerinë, kokëfortësinë e paargumentuar, por nuk cënon autoritetin e dijetarëve. Hadithologu i shekullit nuk ka qenë kundër katër dijetarëve të medh'hebeve, por kundër imitimit të verbër; kundër përceptimit të medh'hebit si shpallje hyjnore, deri në atë masë sa që të dalësh nga medh'hebi është sikur të dalësh nga feja; kundër pasuesve të medh'hebit të cilët refuzojnë Traditën Profetike me justifikimin e mosdaljes nga medh'hebi.

- Hoxha i hadithit, Imam Albani,

kishte mjaft mospërputhje mendimesh me hoxhallarët e kohës, por “problemet” që donte të ndante me të tjerët ishin të karakterit parimor dhe nuk lidheshin me emra individësh apo me çështje personale.

- Si muslimanë, ne duhet të jemi krenarë për përkatësinë tonë fetare. Mbrojtja e identitetit dhe largimi nga imitimi i verbër i kulturave të huaja është domosdoshmëri. Siç e ruajmë etninë dhe gjuhën, duhet ta ruajmë edhe fenë. Islami ka ushtruar ndikim themelor në mbijetesën dhe në formësimin e identitetit kulturor dhe kombëtar. Islami na ka ruajtur nga asimilimi. Ne, muslimanët shqiptarë, duhet të kuptojmë se përfaqësojmë besimin islam në Evropë, të rrethuar nga katolikë dhe ortodoksë, gjë që e rrit përgjegjësinë dhe detyrimin tonë për të qenë përfaqësues të denjë të besimit islam.

- Muslimani duhet ta ndërtojë identitetin e tij mbështetur në parimet dhe moralin islam. Tendencat e kohës nuk duhet ta largojnë atë nga shembulli i më të dashurit, Profetit, alejhis-selam. Ndër çështjet që ka prodhuar mjaft debat është mjekra. Islami nuk fillon me mjekrën, as nuk humbet Xheneti pa mjekër, por ajo është një urdhër profetik, është një traditë e të gjithë profetëve. Mjekra është një veçori tipike mashkullore, e mos të flasim pastaj për efektet shëndetësore pozitive të mjekrës së pastër. Vite më parë mjekra nuk ishte aq popullore, si rezultat muslimanët me mjekër shiheshin me sy disi ndryshe. Rikthimi në modë i saj u bë në mënyrë masive gjatë vitit 2016, nga një sërë personalitetesh të njohura në fusha të ndryshme, futbollistë, aktorë, politikanë etj. Për shumë personazhe mjekra u bë dekor në fytyrë. Padyshim, qëllimi i muslimanit ndryshon nga qëllimet e modeleve të ndryshme.

- Të njohim problemin me të cilin ballafaqohemi është më e rëndësishme sesa të njohim zgjidhjen, sepse paraqitja e saktë e problemit shpie tek zgjidhja.

A i njohim ne problemet e Thirrjes Islame në vendin tonë?

Në këshillën e tij, hoxhë Nasirudin Albani, fton në Islamin e pastër, në largimin nga zakonet e huaja dhe risitë e sajara dhe në bashkimin nën flamurin e të Dërguarit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-le.

Neufel KAZAZI

NJË DITË PLOT BEKIME DHE MIRËSI PËR TIRANËN DHE SHQIPËRINË!

Vizita dhe prania e një grupi dijetarësh të shquar të ymetit tonë islam nga India, Pakistani, Britania e Madhe, Afrika e Jugut, etj., me në krye Shejkhul-Islamin Mufti Muhammed Takijuddin El-Uthmani, sot në Tiranë, ishte pa dyshim një shenjë e madhe bekimesh dhe mirësie hyjnore për shqiptarët dhe Shqipërinë!

Aty ku shkel këmba e tyre, aty ku janë ata dhe përschirtja e tyre, aty zbret mëshira dhe bekimet hyjnore!

Ishte një moment i dëshmuar takimi me Hoxhën e dashur, Mufti Muhammed Takijuddin El-Uthmanin, si dhe dëgjimi e përfitimi nga zemërgjërësia e tij, dija dhe eksperiencat e panumërta.

Autor i mbi 80 vëllimeve plot vlerë e dije, Mufti Muhammed Takijuddin El-Uthmani është sot, njëri prej dijetarëve elitarë më të spikatur të botës sonë islame.

Vizita të tilla elitare duhet të jenë më të shpeshta, sepse bashkësia e muslimanëve shqiptarë ka përherë e më shumë nevojë për zëra elitarë, që udhëzojnë rrugëtimet e tyre plot smog izolimi, sot e 28 vite të kësaj ripërtëritjeje kombëtare!

Institucionet tona islame e kanë të domosdoshme sot rritjen e bashkëpunimit me qendrat botërore të Thirrjes Islame dhe institucionet e tyre elitare, duke filluar me Dijanetin e Turqisë, Ministritë e Vakëfeve të Kuvajtit, Emirateve, Arabisë Saudite, Marokut, Egjiptit, Unionin Botëror të Dijetarëve Muslimanë, Komisionin



Evropian për Fetva, Akademinë Botërore të Fikhut, e shumë e shumë institucione të tjera botërore, që do ta ndihmonin shumë këtë rrugëtim, sidomos sot në kohën e madhe të rimëkëmbjes së ymetit islam dhe rizgjimit të vetëdijes islame në mbarë botën tonë.

Më bekoj All-llahu sot, me këtë takim zemre me Hoxhën e urtë, që na mbushi zemrat me këshillat dhe fjalët e tij plot respekt e nderim për shqiptarët, si dhe me udhëzimet e tij për krejt ne, në përballjet tona me sfidat e kohës!

Na dritësove, i shtrenjti Hoxhë!

Imam Muhamed B. Sytari

Myfti i Zonës Shkodër

Tiranë, 23 qershor 2018





Dr. Ali M. Es-Salabi,
Shkrimtar, historian - Libi

Për atë, që dëshiron ta dijë, se përse bota i shikonte zgjedhjet në Turqi me shqetësimin e dashamirësit dhe urrejtësit, ky është një shkrim i rëndësishëm dhe larg fanatizmit e ekstremizmit.

Turqia e Atatürkut, themeluesit të republikës së re turke, pas rënies së Kalifatit, hoqi dorë nga pasuria e Perandorisë Osmane në të tre kontinentet, me marrëveshjen e paqes së Lozanës 1923-2023.

Përse Erdogan flet për vitin 2023?

Dhe, përse Evropa, sidomos Gjermania është e shqetësuar tejmas dhe e frikësuar për vitin 2023?

Marrëveshja u arrit mes aleatëve triumfues të Luftës së Parë Botërore, të cilët akoma kanë të pushtuara pjesë të mëdha të Turqisë. Britania i vendosi këto kushte të ashpra dhe të padrejta për të sunduar ndaj Turqisë deri në 100 vitet e ardhshme.

PREJ KËTYRE KUSHTEVE JANË:

- Anulimi i Kalifatit Osman dhe internimi i Sulltanit dhe familjes së tij jashtë Turqisë.

PËRSE ERDOGANI FLET PËR VITIN 2023?

Dhe, përse Evropa, sidomos Gjermania është e shqetësuar tejmas dhe e frikësuar për vitin 2023?

- Konfiskimi i të gjithë pasurive të Kalifatit dhe Sulltanit.
- Shpallja e shtetit laik.
- Ndalimi i Turqisë në nxjerrjen dhe përpunimin e naftës në tokat e saj, por mund të importojë vetëm naftë.
- Konsiderimi i ngushticës së Bosforit, kanal ujërash ndërkombëtare dhe nuk i lejohet Turqisë të marrë asnjë lloj takse nga kalimi i anijeve. (Gjiri i Bosforit është nyja lidhëse mes detit të Zi dhe detit të Marmarasë, e prej aty në detin Mesdhe). Pra, kalim ujqor tepër i rëndësishëm, siç është kanali i Suezit.

Kjo marrëveshje punon së vepruari në vitin 2023, duke kaluar kështu 100 vitet.

Mbas deklaratave të Erdoganit vihet re, se me vitin 2023 përfundon epoka e Turqisë së Vjetër dhe nuk do të ketë më asgjë prej saj. Turqia do të shpejtojë në nxjerrjen dhe përpunimin e naftës, hapjen e kanalit ujqor të ri, që lidh dy dete, atë të Zi me atë të Marmarasë, përgatitje për të arritur vendosjen e taksave të reja anijeve lundruese.

Prej këtu, mund të kuptosh disa anë të konfliktit të ashpër mes Turqisë dhe Perëndimit.

Është zullum dhe budallallëk i madh, që të dish prej Perandorisë Osmane, vetëm:

Politikën turqëzuese, Ligën e Unitetit dhe Përparimit, ekzekutimin e intelektualëve arabë dhe të tjera dukuri të padrejta, që sunduan vendin në periudhën e fundit të Perandorisë

Osmane. Sidomos, në 50 vitet e fundit të Perandorisë, e cila sundoi 500 vitet. Kjo, pasi asaj iu vërsul e gjithë bota mbarë me intriga nate dhe dite të gjitha formave. Depërtuan në nyjet e saj çifutët dhe u quajt “njeriu i sëmurë i Evropës”. Kështu që, nuk qe më e aftë të drejtonte vendin dhe filloi të copëtohej e të shpërbëhej një pas një, derisa ra e gjitha.

PYETJA QË LIND:

A nuk është zullum të injorohet e të fshijmë (apo të barazojmë) 500 vitet sakrificë në lartësimin e flamurit të Islamit me 50 vitet e fundit të jetës së saj?

A nuk është zullum të injorohet më shumë se 100 milion myslimanë, të cilët hynë në Islam për shkak të saj?

A nuk është zullum të injorohet rolin e saj në pengimin e Iranit në shtrirjen e tij në vendet arabe, e për këtë shkak hyri në betejën “Xhald Jeran”?

A nuk është mosmirënjohje, që intelektualët tanë të injorjnë faktin se Perandoria Osmane shpëtoi të burgosurit myslimanë në Andaluzi prej gjykatave të inkuzicionit, madje edhe të burgosurit çifutë. Këtë gjë e bëri përmes betejave detare përvëluese nën udhëheqjen e dy trimave heronj, dy vëllezërve Barbarosa ndaj Spanjës dhe Portugalisë?

A nuk është prej injorancës, errësirës dhe mosmirënjohjes, që të rinjtë tanë të mos njohin asnjë nga betejat e paimagjinueshme e Nikopolisit, e cila mund të jetë e ngjashme me një luftë

botërore, ku ishin bashkuar Rusia, Britania e Madhe, Franca, Gjermania, Italia, Belgjika, Skocia, Luksemburgu, Polonia dhe Bullgaria me urdhër të Papës, Boniface IX për të ekzekutuar Perandorinë Osmane, por rezultati si zakonisht qe disfatë e madhe për Evropën dhe Rusinë dhe fitore e ndritur e Osmanëve nën udhëheqjen e Bajazitit të Parë, duke u shtrirë Perandoria Osmane nga Eufrati në Lindje deri në Danub në Perëndim?

Ndoshta, në mendjen e lexuesit mund të lind pyetja:

Ku ka qenë Amerika dhe cili ishte qëndrimi i saj në këtë luftë?

Përgjigja është, o miku im:

Amerika nën udhëheqjen e Xhorxh Washingtonit atë kohë pagunte xhizje algerianëve nën drejtimin e “Biklu Hasen”, për të përfutur:

- Mbrojtje të anijeve amerikane në detin Mesdhe.
- Mbrojtje të familjeve amerikane, të cilat ishin zënë rob në betejën detare, që nuk është vendi për ta përmendur këtu. Më poshtë edhe teksti i Marrëveshjes Amerikane mes Xhorxh Washingtonit dhe Perandorisë së Kalifatit:

“Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të paguanj 12 mijë lira floriri osmane çdo vit, në këmbim të liritimit të anijeve amerikane të konfiskuara nga Algjeria dhe të mos cënohen anijet amerikane në detin Mesdhe dhe në oqeanin Atlantik”.

Ndërsa, unë tashi të them në vesh se:

Ndoshta kjo marrëveshje mund të zgjidhë enigmën e luftës së Francës ndaj Algjerisë, ku francezët vranë më shumë se një milion e gjysmë dëshmorë algerianë.

A nuk është mungesë edukate të kritikojmë Perandorinë Osmane, e cila e vetme qëndroi duke i bërë ballë 25 fushatave të kryqëzatave ndaj botës islame, e ajo gjithmonë ishte fitimtare?

A nuk është zullum të shajmë Perandorinë, e cila, sulltani i fundit i saj, Sulltan Abdulhamidi, vuri fronin e tij si çmim për të mos lëshuar Palestinën dhe mos dorëzimin e saj tek çifutët?

A nuk është mosmirënjohje, që të rinjtë tanë të mos dinë asgjë për Sulejman Kanunin, i cili, për vdekjen e tij ranë këmbanat e kishave të Evropës dhe u mbajtën mesha tre ditë me urdhër të vetë Papës? Ai qe komandanti i betejës së “Mohakos”.

Kështu është edhe Pajaziti i Parë,

komandanti i betejës së paharrueshme të Nikopolisit, i cili ndali botën përpara këmbëve të tij, duke pritur rezultatet e betejës, që ishte ashtu siç ishte.

Kështu është edhe Selimi i Parë, komandanti i betejës së Xhadiranit, e cila qe vendimtare ndaj shtrirjes Safavite.

Kështu është edhe Sulltan Abdulhamidi, poseduesi i Palestinës, që u tha çifutëve: “Palestina nuk është pronë e Sulltan Abdulhamidit, por e gjithë myslimanëve. Mi mbliidhni firmat e të gjithë myslimanëve, se ata heqin dorë nga Palestina, që unë të heq dorë prej saj”.

Kështu është edhe Mehmet ibn Muradi, i quajtur Mehmet Fatihu, sepse ai çliroi Konstandinopojën, e cila ishte shpresuar të çlirohej prej çdo udhëheqësi të madh mysliman, që nga koha e Emevitëve. Kjo sepse i Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Patjetër, do të çlirohet Kostandinopoja. Sa i mirë është emiri, prijësi i saj dhe sa e mirë është ajo ushtri!” (Hakimi, Tabarani, Ahmedi)

Dhe ky çlirim u arrit nën udhëheqjen e emirit Sulltan Mehmet Fatihut (r.h), më 29 mars 1453, ndërkohë që ai ishte djalos 21 vjeçar.

A nuk është mosmirënjohje e madhe për këta kolosë, që të rrinë heroizmat e tyre në fshehura në raftet e bibliotekave publike dhe private dhe të rinjtë tanë të mos dinë gjë për ta, në kohën që ata dinë numrin e këpucëve të lojtarëve të famshëm, artistëve të ndryshëm të filmave etj?

DHE, SË FUNDMI:

A nuk është zullum që librat dhe programet mësimore të arabëve edhe myslimanëve të mos përmendin Bajazitit, apo Selim e Parë, Sulltan Abdulhamidin, apo Sulejman Kanunin?

Këta janë të parët e mi, prandaj m'i sill mua

Nëse na bashkon ne, o thirrës i bashkimit.

Përktheu nga arabishtja dhe përshtati në shqip:

Lavdrim Hamja

Referenca:

- Historia e Perandorisë Osmane, Muhamed Ferid
- Periudha Osmane, Mahmud Shakir
- Historia e Perandorisë Osmane, Jillmaz Oztunja.

PËRPLASJA MES DIJES DHE DHUNËS



Muhidin Ahmeti

Kur flasim për terrorizimin në përgjithësi, një gjë duhet të kemi të qartë se ne flasim gjithë kohën për pasojat dhe jo për shkaqet. Duke filluar nga fanatizmi, radikalizmi, ekstremizmi, terrorizmi, që të gjitha këto iz-ma janë pasojë e shkakut i këtyre është diku tjetër. Personalisht besoj se ne jetojmë në kohën e një përplasjeje të madhe, e paralajmërimit e saj e gjejmë në Kur'an dhe atë në fillimin e historisë së krijimit.

Në surën el-Bekare ajeti 30-33 Engjëjt protestuan ndaj vendimit të Zotit (xh.sh) për të krijuar mëkëmbës në Tokë. Argumenti i tyre ishte: Ai do të bëjë fesad dhe do të derdh gjakun. Si përgjigje All-llahu ia “mësoi Ademit të gjitha gjërat me emrat e tyre”. Dijetari dhe reformatori i njohur islam Xhevad Said thotë se kjo është një përplasje simbolike në mes shkencës dhe dhunës.

Kur është fjala për dhunën shtrohet pyetja si mund ta mposhtim, ta mbizotërojmë atë? Cili është ilaçi i duhur për t'i shëruar kokat e nxehta, të paformuara, të papjekura dhe të dhunshme të njerëzve. Përgjigjen e jep All-llahu (xh.sh) duke thënë: Ve al'leme Admel-esmae kul'leha- “ia mësoi Ademit të gjitha gjërat me emrat e tyre”.

Prandaj, them se shkakut i të gjithë iz-mave është injoranca e njeriut. Injoranca është errësirë, dituria dritë. Errësira nuk zhduket pa ardhur drita.

Këtu shihet qartë që Krijuesi ynë që në fillim kërkon që problemi i dhunës që është produkt i errësirës së injorancës të trajtohet si një fenomen njerëzor dhe të zgjidhet me imperativin e dritës që është instrumenti më i fuqishëm për largimin e errësirës dhe ndriçimin e skutave të errëta të mendjes dhe jetës së njerëzve.



Idmir Plaku,
Imam - xhamia "Ebu Bekër"

HARMONIA BASHKËSHORTORE NË AJETIN: "AI VURI MES JUSH DASHURI DHE MËSHIRË"

lindja e dashurisë mes çiftit. Dhe e treta, dhembshuria midis dy gjinive. Kjo veçori përbën një veti shumë të ndjeshme që mbart në vetvete çdo gjë të mirë. Ndaj kësaj veçorie Allahu (xh.sh) i tërheq vëmendjen burrave duke u thënë: "Gratë janë rroba për ju e ju rroba për to"³ Në këtë mënyrë burri dhe gruaja janë përshkruar që të dy si veshje e njëri-tjetrit, e jo njëri si veshje e tjetri si trup. Ashtu siç merr kuptim veshja, ajo është diçka që qëndron shumë pranë trupit. Kjo afërsi rrobë-trup i ngjason intimitetit që ekziston mes bashkëshortëve.

Marrëdhënia midis bashkëshortëve e krahasuar me atë të veshjes dhe trupit tërheq vëmendjen tonë se kjo lidhje nuk është këndvështrim i thjeshtë. Në të është prezent mëshira e Allahut (xh.sh), e cila është indikator i forcimit apo pakësimit të dashurisë bashkëshortore. Me të drejtë mund të lind pyetja: Si ta fitojmë dashurinë e bashkëshortes? Allahu me urtësinë e Tij hyjnore i dha mundësi burrit dhe gruas që përmes sjelljes së tyre ta fitojnë, ruajnë e forcojnë dashurinë ndërmjet tyre, si një domosdoshmëri e ruajtjes së familjes e për rrjedhojë dhe e shoqërisë.

Disa vepra që burri nëse i vepron mund të fitojë dashurinë e bashkëshortes, ndër këto po përmend si vijon:

Fjala e mirë për bashkëshorten në prezencën e në prani të familjarëve të burrit është vepër e pëlqyer që ka ndikim

pozitiv në mirëkuptimin dhe harmoninë mes bashkëshortëve. Por të kundërtën mund të themi për kritikën apo vërejtjen në prezencën e familjarëve të burrit apo të afërmeve të saj. Burri që dëshiron të këshillojë gruan e tij, duhet të zgjedhë kohën dhe vendin e përshtatshëm. Këshillat në vetmi dhe atmosferë intime, janë më të frytshme dhe të dobishme se ato publike. Këto këshilla tregojnë sinjeritet dhe jo arsye për ta turpëruar në prani të njerëzve. Këshillat e shprehura në vetmi dhe lavdërimi i gruas në praninë e të tjerëve, do ta nxisin që ajo të përmirësojë gabimet e saj. Një sjellje e tillë do të ndihmojë në forcimin e dashurisë bashkëshortore.

Respekti ndaj prindërve dhe familjes së gruas është shkak për të fituar dashurinë e respektin e saj. Si njerëz që janë pajtuar që vajza e tyre të jetë bashkëshortja jote, duhet të gëzojnë respekt të veçantë. Sjellja e mirë ndaj tyre ndikon pozitivisht në forcimin e lidhjes martesore dhe në rritjen e dashurisë. Islami është fe, e cila thërret në sjellje të mirë ndaj njerëzve në përgjithësi dhe ndaj të afërmeve në veçanti. Me sjellje të mirë ai do të përfitojë mbështetjen dhe respektin e tyre. Sjellja e mirë është provë e drejtësisë, e cila në çdo situatë është e lavdëruar. Përherë shumë burra insistojnë, që gruaja të sillet mirë ndaj familjes së burrit, por në fakt ata vetë me fjalë e vepër nuk e vërtetojnë se një trajtim të tillë e kanë merituar.

Ndihma e ndërsjellë në vepra të mira mes burrit e gruas si namazi i natës,

leximi i përbashkët i Kur'anit, agjërimi vullnetar, vizitat e përbashkëta të familjes, fqinjëve etj, forcon lidhjen e harmoninë bashkëshortore. Padyshim që adhurimet që kryhen bashkërisht e shtojnë begatinë, respektin dhe dashurinë e ndërsjellë. Kështu fitohet mëshira e Allahut (xh.sh) për të cilën të gjithë kemi nevojë. Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Allahu e ka mëshiruar burrin, i cili zgjohet natën për të falë namaz dhe zgjon gruan e tij, e nëse ajo refuzon e spërkat me ujë në fytyrë. Allahu e ka mëshiruar gruan, e cila zgjohet natën për të falë namaz dhe zgjon burrin e saj, e nëse ai refuzon e spërkat me ujë në fytyrë".⁴ Kurse në një hadith tjetër, Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Kur njeriu e zgjon bashkëshorten e tij natën dhe së bashku i falin dy rekatë namaz, të dy shkruhen në mesin e atyre që e përmendin shumë Allahun."⁵

Kujdesi për shëndetin e gruas është një tjetër arsye për fitimin e dashurisë së saj në familje. Gratë për nga natyra janë më të dobëta se burrat. Për këtë edhe problemet e tyre shëndetësore janë të veçanta. Këtë fakt burri nuk duhet ta neglizhohet e as ta harrojë diçka të tillë. Mbështetja e plotë dhe përkrahja gjatë sëmundjeve, e ushqen dhe forcon lidhjen martesore. Shtatzënia si një gjendje e ndërlukuar psikofizike, pas të cilës pritet ardhja e nja pjesëtari të ri në familje, kërkon kujdes dhe ndihmë të veçantë. Pakujdesia në këtë periudhë mund të ketë pasoja serioze, për shëndetin në veçanti dhe martesën në përgjithësi. Kurse, për sa i përket gruas edhe me pozitën e saj në familje mund të fitojë, ruajë dhe forcojë harmoninë familjare. Mjafton të përmendim këshillën e urtë që ka mbetur në kujtesën e historisë është ajo e Imame bint El-Harithes (r.a), drejtuar bijës së saj Ummi Ejās natën e martesës. Në këshillën e saj i drejtohet me këto fjalë vajzës së saj:

Bija ime e dashur, sot do të ndërrosh ambientin prej ku ke lindur, do dalësh nga çerdhja ku je rritur. Sikur të ekzistonte ndonjë femër që nuk martohet për shkak të pasurisë që ka te prindërit dhe nevojës së tyre për të, do të ishte njeriu më i pasur, por gratë për burrat janë krijuar dhe ata për gratë janë. Prandaj të jap këto porosi:

E para dhe e dyta: Nënshetroju atij me kënaqësi dhe respektoja kërkesat.

E treta dhe e katërta: Kujdes nga

4. Transmetuar nga Ebu Davudi.

5. Transmetuar nga Ebu Davudi.

pamja e shëmtuar dhe era e pakëndshme e trupit, e mos lë vend papastërtie në trupin tënd.

E pesta dhe e gjashta: Kujdesu për kohën e gjumit dhe ngrënies së tij, sepse shqetësimi nga uria dhe pagjumësia sjellin telashe të rënda.

E shtata dhe e teta: Kujdesu për pasurinë dhe familjen e tij. Mënyra më e mirë për t'ia ruajtur pasurinë është mirë vlerësimi, ndërsa mënyra më e mirë për tu kujdesur për familjen e tij është mirë-edukimi dhe mirësjellja.

E nënta dhe e dhjeta: Përfilli urdhrat e tij dhe mos ia hap sekretet, sepse nëse nuk ia përfill urdhrat do t'ia hidhërosh zemrën, e nëse i hap sekretet e tij do ta tradhtosh. Pastaj, mos u gëzo kur ai është i hidhëruar dhe mos rri e pikëlluar kur ai është i gëzuar. Lumturia nuk fshihet te ndonjë njeri tjetër, ajo është në duart tuaja.

Ruajtja e harmonisë familjare është garanci e ruajtjes së shoqërisë. Asnjëri nga të dy, qoftë burri apo gruaja, nuk është hije e tjetrit, por që të dy kanë përgjegjësi të njëjta. Allahu (xh.sh) i ka përshkruar burrit dhe gruas martesën për të kënaqur dëshirat e tyre seksuale, karakteristike për natyrën njerëzore, në mënyrë të tillë që kënaqësia të shoqërohet përherë me përgjegjësinë familjare. Transmetohet se sahabët pyetën: "O i Dërguar i Allahut, vallë edhe në kënaqjen e epshit ka shpërblim!? Çka mendoni, sikur dikush prej jush epshin do ta përdorte në të ndaluar, vallë nuk do të meritonte mëkat për këtë? Gjithashtu, nëse e përdor në të lejuar, për këtë do të ketë shpërblim" u përgjigj i Dërguari (a.s)⁶

Allahu (xh.sh) në ajetin kur'anor: "Ai vuri mes jush dashuri dhe mëshirë" tregon se harmonia familjare midis pjesëtarëve të familjes dhe në mënyrë të veçantë midis burrit dhe gruas nuk është një raport i thjeshtë. Ky raport ka karakter shpirtëror dhe është burim i dashurisë, mirëkuptimit, besimit reciprok dhe ndjenjës së sakrificës. Në marrëdhëniet bashkëshortore secili nga bashkëshortet mundohet të përmirësohet gjithnjë e më shumë. Çdonjëri nga bashkëshortet plotëson dhe pasuron tjetrin.

Së fundmi i lutem Allahut që të na ruajë harmoninë familjare e të na begatojë me ndjenjën e besimit. Zoti ynë, bëj që gratë dhe fëmijët tanë të jenë burim kënaqësie për sytë tanë.

6. Transmetuar nga Muslimi.



PEJGAMBERI (A.S) KA THËNË:

*"Në qoftë se
ju vjen ndonjë njeri,
të cilit i pëlqeni fenë
dhe moralin e tij
martojeni.
Në qoftë se
nuk veproni kështu,
atëherë në tokë
do të ketë
trazira dhe fesat
(shthurje)."*

(Transmetuar nga Buhariu)

وَجَعَلَ بَيْنَكُمْ مَوَدَّةً وَرَحْمَةً

وَجَعَلَ بَيْنَكُمْ مَوَدَّةً وَرَحْمَةً إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِّقَوْمٍ يَتَفَكَّرُونَ

سورة الروم الآية ٢١

PALESTINA, TOKA E SHENJTË E SHPALLJEVE HYJNORE

Palestina është një pjesë e natyrshme e vendeve të Levantit (Shamit) dhe është një zonë historike në zemër të Lindjes së Mesme.

Ky vend është i rrethuar nga vendet arabe dhe një pjesë e madhe e popullsisë aty janë arabë. Pjesën tjetër të popullsisë e përbëjnë hebrenjtë e ardhur, si edhe kombësi të tjera.

Palestina gjendet në lindje të detit Mesdhe, duke qenë urë lidhëse mes Azisë Perëndimore, Afrikës Veriore dhe Gadishullit të Sinaït.

Palestina është vendi i mesazheve hyjnore dhe djepi i qytetërimeve të njerëzimit.

Ajo është Kibla e parë e muslimanëve.

Në Palestinë është Mesxhidi i Kudsit, ose siç quhet ndryshe “Mesxhidul-Aksa”, e cila qëndron krenare përballë stuhive të historisë.

Eriha, një nga qytetet e lashta të Palestinës, është dëshmitare e njëzetet e një qytetërimeve, që nga mijëvjeçari i tetë para Isait (a.s.).

Gjurmët e gjetura që tregojnë për praninë njerëzore, në jug të Detit të Taberias, në Palestinë, datojnë deri në rreth 600 mijë vjet (p.e.s.).

Në Palestinë janë gjetur gjurmë që nga periudha e Neolitit (10,000 BC 5000 - BC), kur u krijuan komunitetet e para bujqësore të stabilizuara; gjithashtu, edhe nga epoka e bakrit (5000 BC - 3000 BC) janë gjetur gjurmë të asaj periudhe, si vegla bakri dhe guri, në afërsi të qytetit Eriha, të Bi'r es-Seb'a

dhe të Detit të Vdekur.

Jebusët dhe Ken'anët, njihen si të parët banorë në Palestinë, për të cilët janë gjetur shënime historike të veçanta.

Emërtimi “Palestinë” i territorit, që sot mban këtë emër, gjendet i përmendur për herë të parë nga Herodoti, pastaj edhe nga historianët të tjerë, grekë dhe latinë. Në shkrimet e lashta, në disa raste ky emër përfshin territorin që nga bregu i detit Mesdhe deri në Luginën e Jordanisë.

Në fillim të epokës së Perandorisë Romake, emri “Palestinë” nënkuptonte vetëm zonën përreth Kudsit. Ky emërtim u përdor edhe në kohën e Bizantinëve dhe tregonte territorin në perëndim të lumit Jordan, që shtrihet në mes të malit Karmel dhe Gazës në jug.

Që atëherë e deri sot, Palestina ka qenë vend i banuar dhe dëshmitare e qytetërimeve të ndryshme.

VEÇORITË GJEOGRAFIKE TË PALESTINËS

Palestina shtrihet përgjatë kufijve të Libanit dhe Jordanisë, duke përfshirë zonën në jug të lumit Litani dhe zonën ngjitur me lumin Jordan, në lindje. Por, që nga vitet njëzet të shekullit të njëzetë, pra që nga koha kur Britania kishte mandatin mbi Palestinën, termi “Palestinë” i referohet zonës prej 26.990 kilometra katrorë midis lumit Jordan në lindje dhe Detit Mesdhe në perëndim, dhe që nga kufiri jugor i Libanit, i hartuar në vitin 1923, në veri, deri në krye të Gjirit të Ukbës, në jug.

Përndryshe, mund të themi se Palestina kufizohet me Libanin në veri, me Sirinë dhe Jordaninë në lindje, me

Gjirin e Ukbës në jug (Deti i Kuq), me Egjiptin (Gadishulli i Sinaït) në jug-perëndim dhe me Detin Mesdhe në perëndim.

Sot, popullsia që banon brenda këtyre kufijve vlerësohet të jetë afërsisht 11 milionë banorë, nga të cilët vetëm 47% janë palestinezë, arabë.

Palestina është e përbërë gjeografikisht nga katër rajone të dallueshme natyrore që janë: Ultësira bregdetare, Lartësitë (malet e Galilesë, Nablusit, Kudsit dhe Khalilit), Gropa e Jordanisë (që ndahet mes Sirisë, Jordanisë dhe Palestinës) dhe Shkretëtira e Nakb-it.

Në bregdetin e Mesdheut, në Palestinë, janë të pozicionuar një numër qytetesh, ku më të rëndësishmit janë: Aka, Haifa, Hadira, Tel Avivi, Askalani, Jaffa dhe Gaza. Këto konsiderohen qytetet më të rëndësishme të Palestinës nga ana gjeografike, ekonomike dhe demografike, pasi në këto qytete bregdetare është përqendruar rreth 60% e popullsisë së përgjithshme të saj, prej së cilës rreth 75% e përbën popullsia hebreje dhe pjesën tjetër popullsia arabe. Në këto qytete gjenden qendrat më të mëdha industriale dhe tregtare. Dy qytetet, Tel Avivi dhe Gaza, konsiderohen si dy nga zonat me popullsinë më të dendur në botë.

Ndërsa, në brendësi të vendit gjenden qytetet historike si Kudi i Shenjtë, qyteti i Halilit (Ibrahimit a.s.), Ramallah, Bejt-lahm, Nasira, etj.

Palestina ka disa fusha pjellore, ku më të rëndësishmet janë fushat veriore mes maleve të Galilesë, fushat Bin Amir



LIQENI TABERIJA

dhe disa fusha në qendër të vendit.

Për sa i përket pranisë së ujit, burimet ujore për rajonin nuk janë të bollshme, por varen kryesisht nga uji i shiut që bie gjatë një periudhe prej 5 muajsh në vit, jo më shumë (nga nëntori në mars).

Liqeni Taberia i Palestinës, është burimi më i rëndësishëm i ujit natyral për të pirë dhe për ujitje në rajon, pasi është liqeni i vetëm me ujë të ëmbël atje, i cili furnizohet nga uji i shiut që bie direkt mbi të, apo nga ujërat e lumit Jordan, i cili furnizohet nga bora që shkrin në pranverë, nga mali i Sheikh-it (Hebron).

Lumi Jordan është lumi më i madh në rajon, duke u derdhur në jug, përmes liqenit të Taberias, për në Detin e Vdekur, që është një det shumë i kripur. Gjithashtu, për furnizimin me ujë shërbejnë edhe depozitimet e ujit në shtresat nëntokësore të vendit.

GJUHA E FOLUR NË PALESTINË

Gjuha amtare e njohur në Palestinë, e cila është folur aty për gati 10 shekuj rresht, është gjuha arabe, por tani kjo gjuhë konsiderohet si gjuhë amtare për vetëm 47% të popullsisë së vendit, për shkak të pushtimit dhe dëbimit të gati gjysmës së popullsisë autoktone palestineze.

Palestinezët dallohen për dialektin e tyre, i cili pozicionohet me grupin e dialekteve karakteristike arabe, të folura në vendet e Shamit (Levantit). Dialekti palestinez ndahet gjithashtu në nën-dialekte, ku qytetet flasin një tjetër dialekt nga ai i fshatrave, apo nga dialekti i beduinëve.

Që nga Mandati Britanik mbi Palestinën, gjuha arabe letrare dhe ajo hebreje, janë dy gjuhë që konsiderohen gjuhë zyrtare në Palestinë e brenda kufijve të vendosur në vitin 1948. Gjuha hebreje filloi të depërtojë në Palestinë gjatë shekujve nëntëmbëdhjetë dhe njëzet, si pasojë e migrime intensive hebreje në Palestinë, dhe si pasojë e

ngritjes së kolonive hebreje në vend. Në të kaluarën, e folura në hebraisht ishte shumë e kufizuar në Palestinë; ajo flitej vetëm nga rabinët hebrej, që ishin të shpërndarë në zona të ndryshme të Palestinës. Pas vitit 1948, hebraishtja u bë gjuhë zyrtare brenda shtetit të ri të formuar të Izraelit. Në përgjithësi, është e mundur të bëhet dallimi midis hebraishtes së vjetër dhe asaj të re; hebraishtja e re është gjuha zyrtare në Izrael, përkrah gjuhës arabe.

Vlen të përmendet se një pjesë e madhe nga të dy popujt, i flasin rrjedhshëm të dyja gjuhët, pa harruar edhe anglishten, si gjuhë të huaj. Gjithashtu, atje gjen pakica që flasin gjuhën armene (palestinezët me origjinë armene), si dhe gjuhët ruse, rumune, jidishe dhe amharike, që fliten nga pasardhësit e emigrantëve hebrej të ardhur në Palestinë, nga anët e ndryshme të botës.

Në këtë shkrim folëm pak, vetëm nga ana e jashtme e Palestinës, por ky vend mban brenda tij një histori mjaft të gjatë e të ngarkuar plot me ngjarje, sa do të duheshin vëllime të tëra për të folur për të. Prandaj, ky shkrim ishte vetëm një hyrje në Palestinë, që do të ndiqet nga dy shkrime të tjera. Shkrimi i ardhshëm do të flasë për kronologjinë historike të këtij vendi deri përpara epokës islame, ndërsa shkrimi i tretë dhe përmbyllës që flet për këtë vend të veçantë të globit tokësor, do të trajtojë Palestinën islame, me lejen e Zotit.

Vijon në numrin e ardhshëm me: “Kronologjia historike e Palestinës deri në periudhën para islame”

Përgatiti:

Msc. Arta Ujkaj, teologe



PEJGAMBERI (A.S) KA THËNË:

“All-llahu

i Madhëruar

nuk i shikon pamjet,

as pasuritë tuaja,

por shikon zemrat

dhe veprat tuaja!”

(Transmetuar nga Muslimi dhe Ibn Maxheh)

Paraditën e së hënës, më 18 qershor 2018, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një takim pune me një pjesë të stafit të Myftinisë, për të diskutuar projektin e programeve verore për nxënësit e kurseve të xhamive të Shkodrës.

Në fillim, Myftiu tërhoqi vëmendjen drejt faktit se fëmijët dhe rinia janë amanet, që nuk mund të nëpërkëmbet nga burokracitë dhe neglizhenca e askujt. Për këtë, ai kërkoi më shumë përkushtim nga sektorët përkatës, në mënyrë që atyre t'i afrohet më e mira e mundshme, sidomos gjatë stinës së verës, kur edhe alternativat janë më të larmishme dhe më të shumta.

Myftiu diskutoi projektin e hartuar prej tij, për të shfrytëzuar kohën dhe mundësitë, që nxënësit dhe të rinjtë të kenë hapësira të larmishme për të kaluar një kohë të mbushur me aktivitete dhe

GATI PROGRAMI VEROR PËR NXËNËSIT E KURSEVE TONA



ekskursione, që ia mbushin verën me larminë e tyre.

Ky projekt i ri do të zhvillohet në

bashkëpunim me imamë dhe institucione dhe ka për qëllim edukimin nëpërmjet aktivitetit dhe kontributit në shoqëri.

GJALLËRIMI I JETËS FETARE, MYFTIU TAKOI IMAMËT TEOLOGË

Paraditën e së enjtes, më 21 qershor 2018, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari zhvilloi një takim pune me grupin e imamëve teologë të angazhuar me derset javore në xhamitë e Shkodrës.

Gjatë këtij takimi u diskutua për vlerën dhe dobësinë e madhe që ka për frekuentuesit e xhamive tona gjallërimi i jetës fetare nëpërmjet shumësisë dhe larmisë së derseve javore, që mbledhin komunitetin përreth imamëve dhe rritjes në aspektin ditor.

Pas analizimit të tabelës së mëparshme, u vendos që derset javore të rinisin nga e hëna, më 25 qershor 2018, pas ndërprerjes

gjatë muajit Ramazan.

Imamët ranë dakord për disa ndryshim në disa prej detajeve të këtij projekti, që do të bëhet publik shumë shpejt.

Gjatë këtij takimi u diskutua edhe për disa çështje të brendshme që lidhen me cilësinë e hytbes së xhumasë, gjuhën dhe nivelin e komunikimit në komunitet dhe angazhimet e imamit në xhami.

Poashtu u ra dakord për tabelën e orareve të ezanit të sabahut dhe faljes së tij në të gjitha xhamitë e Shkodrës dhe gjallërimin e xhamisë së fshatit Luarëz përgjatë sezonit veror.



PROGRAMI 10 JAVOR I HYTBEVE NË XHAMINË E LUARZIT, VELIPOJË 29 QERSHOR - 31 GUSHT 2018	
PROGRAMI:	
	1- 29 qershor 2018, teologu Ervil Kuçi: "FJALA E MIRË, SADEKAT".
	2- 06 korrik 2018, teologu Adem Pizga: "TURPI, VEÇORI E BESIMTARIT".
	3- 13 korrik 2018, teologu Gilman Kazazi: "VLERAT MORALE TË SHTYLLAVE TË ISLAMIT".
	4- 20 korrik 2018, teologu Idrir Plaku: "DASHNIA E SAHABËVE PËR TË DËRGUARIN (A.S.)".
	5- 27 korrik 2018, teologu Adrian Uraj: "MIRËSJELLJA NË ISLAM".
	6- 03 gusht 2018, teologu Durim Kasemi: "RESPEKTI NDAJ PRINDIT".
	7- 10 gusht 2018, teologu Adil Cukali: "RUAJTJA E AMANETIT NË ISLAM".
	8- 17 gusht 2018, teologu Altin Nikshiqi: "BESIMTARËT JANË VËLLEZËR".
	9- 24 gusht 2018, teologu Naim Drijaj: "FAMILJA NË KUR'AN E HADITH".
	10- 31 gusht 2018, teologu Arben Halluni: "ISLAMI FË E DIJES QË NDËRTON".

U INAUGURUAN DY ÇEZMET E REJA TE XHAMIA "EBU BEKËR"

Të xhumanë, më 22 qershor 2018, u inauguruan dy çezmet e reja të xhamia "Ebu Bekër", bamirësi komunitare e të nderuarit, Haxhi Besnik Elbasani.

Gjatë hytbes së mbajtur në xhaminë e madhe të qytetit, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari ftoi besimtarët të marrin pjesë në inaugurimin e dy çezmeve të reja, duke theksuar se kjo bamirësi e të nderuarit, Haxhi Besnik Elbasani, ka një vlerë të madhe dhe një shpërblim të papërshkrueshëm tek Zoti i gjithësisë.

Myftiu tha se, bamirësia është tipar i muslimanëve shkodranë, të cilët ndër shekuj kanë ditur të dhurojnë dhe të ndërtojnë në shërbim të fesë së tyre.

"Kemi nevojë që këtë shpirt të madh ta trashëgojmë edhe tek fëmijët tanë, të cilët e kemi për detyrë t'i edukojmë me këtë



virtut të njerëzve të mirë e besimtarëve të përkushtuar", tha ndër të tjera.

Pas përfundimit të xhumasë, Myftiu me një grup besimtarësh, inauguruan së

bashku çezmet e reja, duke u lutur për shëndetin dhe mbarësinë e kontribuuesit dhe përfitimin prej kësaj bamirësie të mbarë komunitetit, kalimtarëve dhe vizitorëve të ndryshëm.

Paraditën e së enjtes, më 28 qershor 2018, në kuadër të aktiviteteve verore me nxënësit e kurseve të xhamive të Shkodrës, Myftinia Shkodër organizoi aktivitetin sensibilizues me temë: "Toka e jonë, Nëna e jonë! – Së bashku mbrojmë ambientin!"

Aktiviteti u zhvillua në zonën turistike të Shirokës, ku një grup nxënësish kontribuuan për pastrimin e bregut të liqenit.

Ndërkohë, teologu Arben Halluni dha edhe një mesazh për mediat e pranishme, duke theksuar se mbrojtja e ambientit dhe natyrës është një thirrje e besimit dhe dëshmi qytetarie.

Ai theksoi se Myftinia Shkodër është e angazhuar prej vitesh në drejtim të promovimit të mesazheve sensibilizuese që nxisin ruajtjen e natyrës dhe mbrojtjen e ambientit, duke iu referuar thirrjeve kur'anore dhe haditheve të ndryshme, që na ftojnë drejt kësaj mirësie.

AKTIVITETI: "TOKA E JONË, NËNA E JONË!"



Myftinia Shkodër ju bën me dije se ka ndërruar jetë në Austri, studiuesi i shquar islam, Mr. Muhidin Ahmeti.

Lajmi për ndërrimin jetë të teologut dhe studiuesit të mirënjohur islam Mr. Muhidin Ahmeti, mësuesit të përkushtuar të Medresës “Haxhi Sheh Shamia”, vaizit elokuent të xhamisë “Ebu Bekër”, publicistit dhe përkthyesit të shquar, aktivistit të afirmuar të Klubit Kulturor “Drita”, ligjëruesit të dashur për rininë dhe intelektualët muslimanë shkodranë në vitet e para të rimëkëmbjes islame, pas vitit 1990, na ka befasuar, por me dorëzim të plotë në përcaktimin e All-llahut të Madhëruar themi: “Të All-llahut jemi dhe tek Ai do të kthehemi!”

Myftinia Shkodër shpreh

NË RAHMET TË ALL-LLAHUT MR. MUHIDIN AHMETI



ngushëllimet e saj për familjen e nderuar Ahmeti, miqtë dhe kolegët në Prizren e Shkodër dhe në krejt trojet tona etnike, për ndërrimin jetë të njeriut të dashur e të shtrenjtë!

Me porosi të Myftiut të Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, ditën e xhuma, më 6 korrik 2018, në të gjitha xhamitë e Shkodrës do të bëhet një lutje për shpirtin e të nderuarit Mr. Muhidin Ahmeti.

All-llahu e mëshiroftë dhe e shpërbleftë me xhennet për kontributet e tij në shërbim të Thirrjes Islame!

MR. MUHIDIN AHMETI

I lindur më: 18. 07. 1962

Vendlindja: Zaplluxhe – Kosovë

SHKOLLIMI DHE ARSIMIMI

Shkollën fillore: 1969 – 1977 në vendlindje

Shkollën e Mesme: 1977 – 1982 – “Medresja e Mesme Alauddin” – Prishtinë.

Fakultetin: 1982 – 1986, Fakulteti teologjik islam në Sarajevë.

Diplomimin: më 24. 02. 1987.

Magjistratura: 2002 – 2004. Universiteti i Studimeve Islame – Karachi Pakistan, dega në Kajro.

ECURIA E USHTRIMIT TË DETYRËS SI PREDIKUES DHE AKTIVIST ISLAM

1988 – 1992: në Prizren - Kosovë

- Imam dhe mësues i mësim-besimit në xhaminë “Sinan Katib” në Prizren

- Autor dhe përkthyes i librave si më poshtë:

- “Dialog me mikun ateist”, Prizren, 1990.

- “Poezi te zgjedhura nga Muhammed Ikballi”, Prizren, 1990.

- “Temat islame”, Shkup, 1991.

- “Të rinjtë dhe droga”, Gjilan, 1995.

1993 – 2000: në Shkodër – Shqipëri Mësimdhënës, pedagog si dhe kryetar i komisionit të lëndëve fetare në Medresën “Haxhi Sheh Shamia”, Shkodër.

Hatib dhe ligjërues në xhamitë e

qytetit: Ebu Bekër, Perash Tophane, Kiras, Xhamia e Plumbit etj.

Themelues i “Klubit kulturor Drita” dhe drejtori i saj.

Themelues, botues dhe drejtor i gazetës “Drita e dijes”

BOTUES DHE AUTOR I LITERATURËS SË PËRSHTATSHME ME KARAKTER ISLAM DHE KOMBËTAR:

- Përmbledhje ligjëratash fetare, Shkodër, 1996.

- Rreth përhapjes së Islamit të Shqiptarët, Shkodër, 1997.

- Libri im i vogël për hallallin dhe haramin, (botues dhe recenzentë), Shkodër, 1997.

- Dhimbjet dhe turpi i Shqipërisë, Shkodër, (Botues), 1997.

- Në rrugën e ngushëllimit e të shpresës, (përkthim nga Boshnjakishtja), Shkodër, 1998.

2001 – 2005 - Periudha e pasluftës në Kosovë

VEPRIMTARITË KRYESORE:

Themelues i Qendrës edukative “Horizonti i Dijes” në Prizren

Themelues i bibliotekës së Qendrës edukative “Horizonti i Dijes” (6000 tituj)

Kursi fetar i fëmijëve mbi 40 fëmijë të rregullt dhe mbi 80 periodikë.

Kursi i të rinjve : mbi 30 pjesmarrës.

BOTIME LIBRASH SI AUTOR DHE PËRKTHYES:

- Keshilla Islame, Prizren, 2000

- Bazat e pedagogjisë kur’anore, Prizren, 2002

- Mësimet e Kur’anit, Prizren, 2003

- Agjërimi i Ramazanit, Prizren, 2003

- Shteti Islam, Prizren, 2004

FUNKSIONET:

- Imam në “Bashkësinë e Shqiptarëve musliman në Wels të Austrisë,

- Kryetar i Unionit të Shqiptarëve musliman në Austri (DAMÖ)

- Anëtar i kryesisë së Bashkësisë Islame të Austrisë – dega – Linz

- Mësues i teologjisë islame në shkollat publike të Austrisë

AUTOR I 4 LIBRAVE:

- 1. Të jetosh në Islam (Hutbe të zgjedhura), Wels, 2006

- 2. “Sfidat e rinisë bashkëkohore në kohën e globalizmit”, Wels, 2008

- 3. Martesa Islame, Wels, 2010

- 4. Mevludi në gj. Shqipe, Wels, 2010

GJUHË TË HUAJA:

Gj. Shqipe - gjuhë amtare

Gj. boshnjake - i rrjedhshëm në shkrim-lexim

Gj. angleze - njohuri të mjaftueshme

Gj. arabe - njohuri të mjaftueshme

Gj. gjermane - njohuri të mjaftueshme

Gj. turke - njohuri të mjaftueshme

(me shkurtime nga: Xhamia - Mesxhid El Resul, Wels - Austri)

PRIZREN, MYFTIU MORI PJESË NË NGUSHËLLIMET PËR MR. MUHIDIN AHMETI



Ditën e shtunë, më 7 korrik 2018 në xhaminë Bajrakli të Prizrenit u organizua ceremonia e xhenazes së studiuesit islam dhe teologut të afirmuar, Mr. Muhidin Ahmeti, që u nda nga kjo jetë të enjten, më 5 korrik 2018 në Wels të Austrisë.

Në këtë ceremoni prezantuan besimtarë të shumtë, familjarë, kolegë, drejtues të bashkësive fetare dhe myftinive nga krejt trojet shqiptare, intelektualë dhe qytetarë të shumtë.

Një mesazh ngushëllimi për të pranishmit dhe familjarët dha edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili theksoi se lajmi i ndërrimit jetë të studiuesit të shquar islam Muhidin Ahmeti, ka shkakuar dhembje të shoqëruara me lutje për shpirtin e tij në Shkodër dhe në mbarë trojet shqiptare.

Myftiu shprehu mirënjohjen e tij dhe respektin e madh për këtë burrë të përkushtuar në shërbimet e tij ndaj Thirrjes Islame në Shkodrën e viteve të para të rimëkëmbjes së besimit pas komunizmit.



Myftiu tha se Shkodra i është mirënjohëse teologëve shqiptarë nga trojet etnike, që nuk ngurruan të vinin në Shkodër e Shqipëri pas ndryshimit të sistemit, me qëllim rimëkëmbjen islame të kombit. Këtu, ai vlerësoi kontributet e dhëna nga Mr. Muhidin Ahmeti, studiuesi Ajni Sinani, bilbili i Gostivarit Hafiz Etem Haliti dhe shumë emra të tjerë të nderuar që nuk harrohen!

Njëkohësisht lajmëroi se prej besnikërisë së medresistëve të periudhës së tij, është edhe hatmeja për shpirtin e tij, që një grup besimtarësh në ShBA kanë organizuar sot, nën drejtimin e të nderuarit Imam Didmar Faja.

Myftiu bëri edhe lutjen e rastit, pas përcjelljes së rahmetliut në varrezën e qytetit.

Në këto ngushëllime, Myftiu shoqërohej nga teologu Idmir Plaku, imam i xhamisë “Ebu Bekër”, xhami në të cilën Mr. Muhidin Ahmeti dha një kontribut të madh me ligjëratat dhe hytbet e tij.

TOLERANCA IME NDAJ TJETRIT DHE MIRËKUPTIMI IM PËR TË TJERËT



"Toleranca ime ndaj tjetrit dhe mirëkuptimi im për të tjerët nuk është me prejardhje evropiane as nga edukimi evropian, por është nga edukimi islam.

Nëse jam tolerant dhe mirëkuptues ndaj tjetrit, kjo është sepse unë së pari jam si musliman me percaktim shpirtëror dhe pastaj si evropian me përkatësi gjeografike.

Për të parën kam meritë unë, kurse për të dytën vendosën të tjerët."

Studiuesi i shquar islam, Nexhat Ibrahim, Prizren

VIZITË NË MUZEUN E QYTETIT DHE NË XHAMINË E DËRGUTIT

Vizitë në muzeun e qytetit dhe në xhaminë e Dërgutit.

Në kuadër të aktiviteteve verore që Myftinia Shkodër ka planifikuar me nxënës të kurseve fetare të xhamive tona, ditën e martë, më 3 korrik 2018, një grup i fëmijëve tanë zhvilluan një vizitë në muzeun e qytetit si dhe në xhaminë e Dërgutit, ku falën edhe namazin e mesditës me xhematë.



NJË DITË PLOT ARGËTIM DHE LOJËRA NË RAZËM

Ditën e enjte, më 5 korrik 2018, Myftinia Shkodër organizoi një ditë argëtimi dhe lojërash në zonën e Razmës, për fëmijë të përzgjedhur nga kurset fetare të xhamive tona.

I pranishëm në këtë udhëtim plot argëtim, lojëra, biseda e këshilla vëllazërore, ishte edhe teologu Arben Halluni, i cili dha edhe mesazhet e tij me rastin e këtij aktiviteti të dobishëm.



GJURMËVE TË TRASHËGIMISË SONË ISLAME DHE KOMBËTARE

Paraditën e së martës, më 10 korrik 2018, një grup nxënësish të kurseve tona fetare zhvilluan në shëtitje të organizuar, si pjesë e aktivitetit: “Gjurmëve të trashëgimisë sonë islame dhe kombëtare”.

Me këtë rast, fëmijët vizituan kalanë Rozafa, gjurmët e xhamisë shekullore të Sulltan Mehmet Fatihut, ambientet e muzeut të kalasë, ku dëgjuan edhe shpjegimet e ciceronit.

Më pas, nxënës të vizituan zonën e trashëgimisë kombëtare të Xhamia e Plumbit dhe vakëfi i Tabakut, ku mësuan shumë të dhëna interesante nga z. Mithat Myftija, si dhe këshillat fetare nga teologu Arben Halluni.



AKTIVITETE ARGËTUESE ME NXËNËSIT NË DET

Paraditën e së enjte, më 12 korrik 2018, Myftinia Shkodër organizoi një ditë argëtimi me nxënës të kurseve fetare, në zonën e Rrjollit.

Nën drejtimin e imamëve dhe teologëve Ervil Kuçi dhe Arben Halluni, nxënës kaluan disa orë të këndshme, plot lojëra zbavitëse, not e biseda vëllazërore.

Një këshillë fetare mbajti edhe teologu Arben Halluni, i cili vuri theksin te rëndësia e shfrytëzimit të kohës për aktivitete me dobi dhe në harmoni me natyrën.



Sipas burimeve zyrtare, ditën e sotme, më 14 korrik 2018, në aeroportin ndërkombëtar të Medinës "Princi Muhammed bin Abdulaziz", mbërriti grupi i parë i haxhilerëve të këtij viti.

Sipas agjencisë UAE_BARQ, paraditën e sotme mbërriti grupi i parë i haxhilerëve të këtij viti. Grupi i përbërë nga 321 haxhilerët e parë erdhi nga Pakistani.

Pas këtij grupi, ditën e sotme mbërritën edhe 30 fluturime të tjera nga vende të ndryshme të botës.

Këtë vit, mijëra muslimanë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe diaspora do të udhëtojnë drejt vendeve të shenjta për kryerjen e haxhit.

Edhe nga qyteti i Shkodrës, një numër i madh besimtarësh janë regjistruar për kryerjen e këtij obligimi fetar, që tubon miliona muslimanë nga mbarë bota në Qaben e Madhnueshme.

HAXHILERËT E PARË MBËRRIJNË SOT NË MEDINE



MYFTIU PRITI REKTORIN E UNIVERSITETIT TË SHKENCAVE HUMANE NË KALIFORNI

Paraditën e së martës, më 18 korrik 2018, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt dhe vëllazëror, rektorin e Universitetit të Shkencave Humane në Kaliforni të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Dr. Aziz Abidin.

Gjatë takimit, Myftiu e prezantoi mikun e shtrenjtë me aktivitetin e Myftinisë Shkodër dhe disa prej sfidave me të cilat përballet aktiviteti i saj dhe i krejt Thirrjes Islame në Shkodër dhe Shqipëri.

Myftiu falënderoi Dr. Abidin



për vizitën dhe dëshirën e mirë të bashkëpunimit, me qëllim forcimin e marrëdhënieve në mesin e institucioneve islame në rang botëror.

Nga ana e tij, Dr. Aziz Abidin e prezantoi Myftiun me aktivitetin e Universitetit Islam të Shkencave Humane dhe larminë e tij, konferencat, takimet, projektet dhe pikat e bashkëpunimit.

Imam Muhamed B. Sytari dhe Dr. Aziz Abidin nënshkruan edhe një marrëveshje bashkëpunimi, që i hap derën aktiviteteve dhe angazhimeve të dobishme në të ardhmen.

DR. AZIZ ABIDIN BASHKËBISEDOI ME IMAMË DHE AKTIVISTË TË MYFTINISË SHKODËR



Me rastin e vizitës në Shkodër të personalitetit të shquar islam botëror, Dr. Aziz Abidin, trashëgimtar i familjes profetike, njëkohësisht rektor i Universitetit të Shkencave Humane në Kaliforni të ShBA, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari shtroi një drekë pune, që i parapriu një bashkëbisedim me imamë, teologë, thirrës islamë dhe aktivistë të Myftinisë Shkodër.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Myftiu i Shkodrës informoi të pranishmit për vizitorin dhe aktivitetin e tij, aktivitetin e gjerë dhe kontributet e mbi 30 viteve shërbim në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Gjatë trajtësës së tij, Dr. Aziz Abidin iu drejtua të pranishëmve me disa

këshilla, që lidhen me aktivitetin islam, urtësinë e thirrjes së tjetrit në Islam, rëndësinë që ka shembulli personal në këtë rrugë, etj.

Ai solli në vëmendje të pranishëmve aktivitetin e tij personal në ShBA, Kolumbi, Meksikë, Brazil, etj., ku theksoi se sot, nuk ka rëndësi sasia dhe numri i të konvertuarve në Islam, që sa vjen dhe rritet, sidomos në vendet e Amerikës Latine, Meksikë, Kubë, Kolumbi, Brazil, etj., por rëndësi ka kuptimi i drejtë i fesë, cilësia në besim dhe udhëzim, si dhe domosdoshmëria e argumentimit se, Islami është feja e Zotit të gjithësisë për mbarë njerëzinë.

Aktiviteti u shoqërua me pyetje të ndryshme nga imamët, si dhe shembuj plot vlerë nga miku i shtrenjtë.



PEJGAMBERI (A.S) KA THËNË:

*"Kujt i vjen
exheli (vdekja)
dhe ndodhet duke
kërkuar dituri,
e takon Allahun
duke mos pasur
dallim mes tij
dhe pejgamberëve,
përveç gradës
së profetësisë".*

*(Tabaraniu në "El-Eusat"
dhe Dejlenu)*



KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPËRISË
MYFTINIA SHKODËR

LISTA E DERSEVE TË PËRHERSHME JAVORE
NË XHAMITË KRYESORE TË SHKODRËS (2)

E HËNË:

XHAMIA RUS, pas sabahut
Ligjërues: **H. Fejzi Zaganjori**
Tema: "Tema të përgjithshme"

XHAMIA "EBU BEKËR", pas akshamit
Ligjërues: teologu **Gilman Kazazi**
Tema: "Muhtesar Sahihul-Buhari"

XHAMIA PARRUCË, pas akshamit
Ligjërues: teologu **Naim Drijaj**
Tema: "Tema të fikhut"

E MARTË:

XHAMIA E MEDRESESE, pas akshamit
Ligjërues: teologu **Adil Cukali**
Tema: "Këshilla të përgjithshme"

XHAMIA DUDAS, pas akshamit
Ligjërues: teologu **Adrian Uraj**
Tema: "Këshilla të përgjithshme"

E MËRKURË:

XHAMIA PERASH, pas akshamit
Ligjërues: teologu **Adem Pizga**
Tema: "Historia e Pejgamberëve"

XHAMIA DËRGUT, pas akshamit
Ligjërues: teologu **Ervil Kuçi**
Tema: "Koment i ajeteve kur'anore"

XHAMIA KIRAS, pas akshamit
Ligjërues: teologu **Ruzhdi Plangaj**
Tema: "Komentim hadithi"

E ENJTE:

XHAMIA TOPHANË, pas akshamit
Ligjërues: **Imam Muhamed Sytari**
Tema: "Të afuarit tek All-llahu"

E XHUMA:

XHAMIA "EBU BEKËR", para xhumasë
Ligjërues: teologu **Idmir Plaku**
Tema: "Akide"

XHAMIA PARRUCË, para xhumasë
Ligjërues: teologu **Naim Drijaj**
teologu **Durim Kasemi**
Tema: "Koment i ajeteve kur'anore"

XHAMIA E "DY VAJZAVE", para xhumasë
Ligjërues: teologu **Lavdrim Hamja**
Tema: "Rijadus-Salihin"

XHAMIA DËRGUT, pas akshamit
Ligjërues: teologu **Altin Nikshiqi**
Tema: "Rijadus-Salihin"

E SHTUNË:

XHAMIA "EBU BEKËR", pas akshamit
Ligjërues: teologu **Gilman Kazazi**
Tema: "Koment i ajeteve kur'anore"

XHAMIA E "DY VAJZAVE", pas akshamit
Ligjërues: **Imam Muhamed Sytari**
Tema: "300 Hadithe"

E DIEL:

XHAMIA PARRUCË, pas akshamit
Ligjërues: teologu **Durim Kasemi**
Tema: "Cilësitë e Resulull-llahut"

XHAMIA KIRAS, pas akshamit
Ligjërues: teologu **Ruzhdi Plangaj**
Tema: "Tema të fikhut"

Vlerësoje kohën tënde dhe rrugëto me imamët e nderuar
drejt horizonteve të reja të dijes dhe urtësisë.
Eja dhe merre dijen nga burimi i saj!

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIA SHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org